



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:219897

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05604125

P.nr.436/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit K. G. nga fsh. G. K. L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.2827/22 të dt.27.09.2022, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datën 18.04.2024, në prani të prokurores së shtetit Nebahate Salihu, të pandehurit, dhe të dëmtuarit M. F. nga L., në po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

K. G., i lindur me dt..... në fshatin G..., K. L., i biri i B. dhe F., e gjinis Sh., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, pronar i agjensionit "A." me seli në Lipjan, me nr. personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 16.06.2022, rreth orës 15:50, në Lipjan, i pandehuri K. G. pas një mosmarrëveshje të atçasshme që kishte pas me të dëmtuarin M. F., rreth një oferte për transportimin e nxënësve të shkollës fillore "D." e cila gjendet në fshatin R., Komuna e L. për në ekskursion, me dashje e ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin në fjalë, duke e goditur me shqelm në bark si dhe duke e gërvishur disa herë në duar,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69 dhe neni 184 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 (dy) vite nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën konform nenin 50 të KPRK-së dënimi me kusht do të revokohet.

I dëmtuari: M. F. nga Lipjani, Rr. "H. B.", pa nr., udhëzohen që kërkesën pasuroro juridike ta realizojnë në procedurë të rregullt civile.

DETYROHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajnë paushallit gjyqësor shumën prej 50-€, si dhe shumën nga 20-€, në Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.2827/22 të dt.27.09.2022, e ka akuzuar të pandehurin K. G. nga fsh. G. K. L., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së mirëpo gjykata e rekualifioi veprën penale duke kualifikuar si vepër penale Sulm nga neni 184 par. 1 te KPRK-se, ngase nga përshkrimi faktik i dispozitivit te aktakuzës vërtetohet se kemi të bëjmë me veprën penale Sulm nga neni 184 par. 1 te KPRK-së e jo nga neni 184 par. 3 lidhur me par.1 te KPRK-së sepse nuk kemi të bëjmë me ndonjë element te par. 3 te këtij neni tek i dëmtuari.

Prokurorja e shtetit në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi që pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave ligjore, me vullnet, pa presion, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë dhe i njëjti të shpillet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I dëmtuari në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe është e vërtet se janë pajtuar me të pandehurin dhe ka kërkuar që kjo çështje të mbyllet sa më parë sepse kanë biznese dhe nuk kanë kohë që të mirren nëpër gjykata.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe njëherit ka shtuar se ka gabuar dhe ndihet tepër i penaduar, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërit sjellje të tilla asnjëherë, me të dëmtuarin është pajtuar dhe e ka lutur gjykatën që ti shqipton një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pranimi i fajit nuk është rezultat i forcës, kërcënimeve apo premtimeve, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konformë nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet.

Matja dhe caktimi i dënimit

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes se veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra, faktin se i njëjti është i moshës së re që lenë për të kuptuar se në të ardhme mund të bëhet anëtar i dobishum i shoqërisë, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla dhe se me të dëmtuarin janë pajtuar dhe kanë raporte të mira për shkak të bizneseve që kanë, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin, pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 47 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku shuma prej 50-€ u caktua në emër të paushallit gjyqësor në bazë të ndërlikshmërisë së rastit,

ndërsa shuma prej 20-€ për Kompenzimin e Viktimave të Krimit u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore-juridike

Vendimi për kërkesën pasurore-juridike u bazua nën 462 të KPPK-së, dhe gjykata e udhëzoi të dëmtuarin që për realizimin e kërkesës pasurore-juridike ta realizoj në procedurë të rregullt gjyqësore pasi që në këtë procedurë gjykata nuk pati prova për vërtetimin e lartësisë së dëmit të shkaktuar.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN

P.nr.436/22 dt.18.04.2024

**Bashkëpunëtorja profesionale
Gentiana Dakaj**

**GJYQTARI
Avdirrahman Gashi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.